

# DINJITETI, INTEGRITETI DHE DHUNA E BAZUAR MBI GJININË NË RAJONIN E POLLOGUT

# 4

## MALLTRETIMI/NGACMIMI SEKSUAL ËSHTË TABU

Ngacmimi seksual i grave në Pollog, ashtu si dhe në të gjithë Maqedoninë, është temë për të cilën nuk flitet. Tentimi për ta hapur këtë temë ndërmjet grave, madje edhe në mënyrë sipërfaqësore rezulton me një heshtje tashmë të vërtetuar, miratim me lëvizjen e kokës, por edhe me ndërprerje të diskutimit me qëndrimin se malltretimi seksual nuk ndodh “... nëse nuk bën asgjë!”. Shkaqet për mosparaqitje ose heshtje për këtë përvojë në të shumtën e rasteve janë frika nga humbja e vendit të punës dhe frika nga gjykimi nga të afërmit dhe rrethina.

## “Problem” që nuk emërohet!


...kisha një shoqe e cila u punësua dhe kishte problem me pronarin dhe u detyrua ta lerë punën.

Në kuptimin e ngacmimit seksual?

Ashtu, ashtu.”

## PËR MOBINGUN HESHTET DHE NUK DENONCOHET!


Ku do të paraqitni mobing (malltretim) në vendin e punës?



PROBLEME TË  
CILAT ËSHTË  
VËSHTIRË TË  
DËSHMOHEN  
DHE TË ZGJIDHEN  
NËPËRMJET  
MEKANIZMAVE  
LIGJORE  
EKZISTUESE!

Mbi 30% e qytetarëve ose nuk do të denonconin ose nuk dinë ku të denoncojnë mobing në vendin e punës. Përqindja më e madhe e qytetarëve (42%), mobing do të paraqesin tek drejtori. Nuk ekzistojnë dallime ndërmjet grave dhe burrave për sa i përket kësaj çështjeje. Ky besim tek autoritetet dhe qasja jo kritike përfaqëson veçanërisht problem nëse malltretimi vjen nga drejtori. Shkaqet për mosdenoncim ose heshtje për këtë përvojë në të shumtën e rasteve janë frika nga humbja e vendit të punës dhe frika nga gjykimi nga të afërmit dhe rrethina.

## KU ËSHTË MBROJTJA NGA DHUNA NË FAMILJE?



Gratë kanë më shumë besim në shërbimet dhe aktivitetet si SOS – telefoni (15%) të cilat nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht përfshirje të ndonjë institucioni, në dallim nga burrat (5,3%).

## NË POLLOG NUK KA ASNJË STREHIMORE PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE!

- Të dy qendrat për punë sociale në Tetovë dhe Gostivar janë vështirë të arritshme për gratë e zonave rurale, ku jetojnë 2/3 e grave të Rajonit të Pollogut.
- Një e treta e popullsisë (33,5%) mendojnë se ekzistojnë mundësitë që dhuna të paraqitet/denoncohet, por më tej mekanizmat për mbrojtjen e viktimave nuk funksionojnë.

## Labirint institucional


„...grua e paraqiti dhunën në organizatën tonë, por çmund të bënim ne? Asgjë. Paraqitet në polici dhe policia mund t’ja mbajë 24 orë bashkë me dhunuesit e tjerë, pavarësisht se ajo është viktimë, sepse edhe policia nuk ka kushte. Në Qendrën për punë sociale kudo që ta dërgojnë – ka në Shkup një srehimore që gjithmonë është përplot, dhe kështu e çojnë nga një vend në një vend tjetër dhe në fund ajo prapë kthehet në shtëpi tek keqbërësi/ dhunuesi, ku situata është më e keqe se sa më parë.”

## NUK ËSHTË PROBLEM VETËM PARAQITJA/DENONCIMI!

### VLERËSIMI I MBROJTJES

Më pak se 10% e të anketuarve mendojnë se shërbimet që ekzistojnë i kënaqin të gjitha nevojat e viktimave të dhunës në familje.

Si i vlerësoni shërbimet momentale për menaxhimin e dhunës në familje?



### Kjo nuk është zgjidhje!

Do të inkurajoje grua të denoncojë dhunë? Çfarë do të bënit në një situatë të tillë?

Unë jo. Sepse e di se si funksionon sistemi. Do t'a këshilloja që ti shkonte pas qejfit dhunuesit me qëllim që t'a shmangte një situatë të tillë."

### DHUNA NË BAZË GJINORE NË HAPËSIRË PUBLIKE

Gratë nga qytete dhe fshatra të ndryshme nga Pollogu, në mënyrë të ndryshme e përjetojnë sigurinë në vende publike.

- Një pjesë e grave nuk ndjehen të lira të dalin vetë në vende publike, ndërkohë që për disa të tjera nuk ekzistojnë kërcënime ose kufizime, përveç atyre që vetë gratë ja vendosin vetvetes.
- Kufizimet sociale ndikojnë mbi lirinë e tyre për lëvizje të pavarur në hapësirën publike.
- Gratë nga Tetova mendojnë se në qytet ka kërcënime më shumë dhe më të mëdhaja se sa në zonat rurale.
- Pjesa më e madhe e grave ndajnë përvoja të ngacmimit/shqetësimit (fjalë provokuese, vërshëllima etj..) kur kanë dalë vetëm në hapësira publike.

Po, sapo të errësohet. Mua edhe me fëmijë për dore më ka rastisur të ndeshem me fjalë provokuese, me vërshëllima, dhe jo vetëm mua, por edhe të tjerëve."

Më e mira të rihet në shtëpi, çështje e sigurtë, sigurtë është. (të qeshura)."

Ka vërshëllima, ka, ajo është diçka e njohur."

Lëri fjalët që ti hedh, problem është nëse të kap. (të qeshura)

## KONKLUZIONE

- Çështja e malltretimit/ngacimit seksual në vendin e punës është temë e cila, krahas rregullativës ligjore ekzistuese, ende është shumë e mbyllur dhe e pastudjuar.
- Mobingu mbi gratë, veçanërisht mbi të punësuarat në industrinë tekstile në rajon është një problem sistemi shumë serioz.
- Përkeqësohen kushtet për parandalimin, mbrojtjen, ndihmën dhe për trajtimin në rastet e dhunës në familje.
- Janë detektuar kapacitete të pamjaftueshme në institucionet si dhe mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave kompetente.
- Në Rajonin e Pollogut nuk ekziston strehimore shtetërore për viktimat e dhunës në familje.
- Pothuajse një e treta e qytetarëve nuk kanë informacione të mjaftueshme ose nuk kanë besim tek institucionet dhe organizatat të cilat meren me problemin e dhunës në familje.
- Vetëqeverisja lokale në rajon nuk ka mekanizëm për trajtimin/menaxhimin e problemit të dhunës në familje dhe vepron vetëm sipas rasteve individuale.
- Dhuna e bazuar mbi gjininë dhe siguria e grave në vende publike është problem dhe çështje tërësisht e padukshme.

## REKOMANDIME

- Hulumtime në kontinuitet, ngritja e vetëdijes dhe sensibilizimi i opinionit për mobingun mbi gratë dhe malltretimin seksual në vendin e punës.
- Zhvillimi i politikave lokale dhe sistemeve të mbrojtjes për menaxhimin e problemit të dhunës në bazë gjinore.
- Mbështetje e OJQ-ve në ngritjen e vetëdijes për ekzistencën e dhunës në bazë gjinore dhe për rritjen e sigurisë së grave në vendet publike.
- Futja e programeve që do të mundësojnë fuqizimin ekonomik të grave -viktima të dhunës në familje.
- Mbështetje aktive e grave - viktima të dhunës në familje nga ana e organizatave joqeveritare.

### Projekt: “Barazia dhe Përfaqësimi Gjinor Përtej Kufijve”



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



ИНТЕРНАЦИОНАЛНИ  
ЗДРУЖЕНСКА



Активност за граѓанинство  
Community Development Institute  
Institut për Zhvillim të Komunitetit

Projekti është implementuar nga Akcija Zdruzenska Shkup dhe Institutit për zhvillim të komunitetit Tetovë

Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Akcija Zdruzenska dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.